



## REPUBLIKA E SHQIPERISE

### Këshilli Kombëtar i Ujit

#### VENDIM

Nr.1, datë 30.07. 2013

#### PËR


#### MIRATIMIN E “STUDIMIT TE FIZIBILITETIT PER PERMIRESIMIN E INFRASTRUKTURES MBROJTJES NGA PERMBYTJET NE LUMIN MAT”

Në mbështetje të nenit 6 pika “c” dhe neni 10, i Ligjit Nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, i ndryshuar, dhe me propozim të Këshillit të Basenit Ujëmbledhës Mat të shprehur me vendimin Nr.10 datë 10.05.2013, Këshilli Kombëtar i Ujit,

#### VENDOSI:

1. Miratimin e studimit të fizibilitetit për përmirësimin e infrastrukturës mbrojtëse nga përmbytjet në lumin Mat, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
2. Në zbatim të këtij studimi, cdo ndërhyrje apo investim të realizohet me projekte të vecanta dhe të miratuara paraprakisht nga autoritetet përkatëse.
3. Ngarkohet, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit, Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Mat dhe Agjencia e Ujit e Basenit Mat, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë.



Fatmir MEDIU  
Zv/Kryetar i K.K.U.  
dhe

KRYETARI  
  
Sam BERISHA

Ministër i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave

Flamur NOKA

**MINISTËR I BRENDSHËM**




Ridvan BODE

**MINISTËR I FINANCAVE**



Florjon MIMO

**MINISTËR I EKONOMISË, TREGETISË DHE ENERGJITIKËS**



Halim KOSOVA

**MINISTËR I SHËNDETËSISË**




Gene RULI

**MINISTËRI I BUJQËSISË ,USHQIMIT DHE MBROJTJES SË  
KONSUMATORIT**

Sokol OLLDASHI

**MINISTËR I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT**



## RELACION

### PER

#### “MIRATIMIN E STUDIMIT TE FIZIBILITETIT PER PERMIRESIMIN E INFRASTRUKTURES MBROJTESE NGA PERMBYTJET NE LUMIN MAT”

Projekti **“Studimi i fizibilitetit per permiresimin e infrastruktures mbrojtese nga permbytjet ne lumin Mat”** eshte fiancuar nga Bashkimi Europian permes programit Infrastructure Project Facility (IPF) ne Ballkanin Perendimor, i cili siguron asistencë ne zhvillimin e infrastruktures moderne ne rajon. Ky projekt fokusohet ne manaxhimin e permbytjeve nga lumi Mat, si dhe ndihmon ne pergatitjen e plani menaxhimi afatmesem, gjithashtu ne nje plan investimi afatshkurter i cili orientohet dhe plotesohet nga dizenjimi koceptual i zhvillimeve infrastrukture te lidhura ngushtesisht me mjedisin dhe analizen ekonomike.

Ky projekt eshte i bazuar ne dy nderhyrje baze te cilat jane ngritja dhe ndertimi i argjinaturave dhe riprofilimi i shtratit te lumit duke pastruar nje pjese te aluvioneve ne seksione te percaktuara. Referuar ketyre dy nderhyrjeve baze eshte bere kombinimi i tyre duke perfituar disa skenare te ndyshem ku nderhyrjet kryesore jane:

- Percaktimi i niveleve te ujit dhe per rrjedhoje i niveleve te argjinaturave pa nderhyre ne shtratin ekzistues te lumit.
- Percaktimi i niveleve te ujit dhe per rrjedhoje i niveleve te argjinaturave me ndrhyrje ne shtratin ekzistues duke e pastruar sipas nje profili te caktuar, te nderthurur me argjinaturat.

Krahasimi i ketyre dy nderhyrjeve baze me njera tjetren kane keto perparesi:

Ne opsionin e rregullimit te shtratit, ritet kapaciteti transportues i lumit persa i perkete sasise se ujit, duke ritur siperfaqen e seksionit terthor duke thelluar dhe pastruar shtratin e lumit. Thellimi dhe pastrimi i shtratit te lumit konsiston ne modifikimin e shtratit te lumit duke ndryshuar karakteristikat hidraulike te shtratit duke shkaktuar edhe nje shtim te aluvioneve pezull qe transportohen drejt grykederdhjes se lumit.

Ne opsionin pa nderhyrje ne shtratin e lumit, nuk planifikohet thellim dhe pastrim i shtratit te lumit, por skarpatat e argjinaturave do te vishen me gure dhe beton per te reduktuar erozionin e materialit mbushes se argjinaturave.

Eshte nje ceshtje e rendesishme qe aktualishte nxjerrja e inerteve mund te konsiderohet si nje rregullim i shtratit te lumit, megjithate menyra e shfrytezimit deri ne ditet e sotme ka krijuar

efekte negative ne ndikimin mjedisor, pasi ne disa raste keto shfrytezime jane bere prane argjianturave duke shkaktuar probleme me to.

Megjithate ky projekt jep rekomandime te rendesishme persa i perkete menyres se ndertimit dhe te monitorimit te te gjitha punimeve te planifikuara.

Perzgjedhja e opsionit me te pershtatshem eshte bere duke marr ne konsiderate faktoret e meposhtem ekonomike, social dhe legjislativ:

- Te gjithe opsionet e propozuara jane konsideruar fizibel per sa i perkete aspektit ekonomik.
- Sa i perkete legjislacionit, projektimi i permbytjeve duhet te jete te pakten 3% probabilitet perseritjeje, per zonat urbane. Ne kete menyre opsioni me 5% probabilitet perseritjeje te plotes eliminohet automatikisht duke mos plotesuar kushtin e siperpermendur.
- Duket qarte se opsionet me shtrat lumi te rregulluar jane me te favorshme nga pikepamja ekonomike, megjithate keto opsione kane nevojte per nje legjislacion te forte te shfrytezimit te inerteve, dhe efica e ketyre opsioneve duket institucionalisht e riskueshme.
- Shfrytezimi dhe mirembajtja eshte nje ceshtje e rendesishme per tu marr ne konsiderate.
- Fitimi margjinale qe mund te arrihet duke investuar me shumte ne sistemin e Argjianturave duke i rritur kuoten e tyre mbi rrezikun e perbytjeve (uljen e probabilitetit te permbytjeve). Kjo do te thote se duke investuar me shumte per sigurine me te larte ndaj permbytjeve perfitimet nuk rriten me zgjatjen e rritjes se kostove.

Duke marr ne konsiderate sa me siper ekspertet e ketij projekti ne mirkuptim te plote dhe ne perputhje me perfitimet e mundshme vendosen qe te miratojne si opsionin A2 si me te pershtatshem, me probabilitet perseritjeje 3% dhe pa rregullim te shtratit te lumit, per arsyet si me poshte:


- Megjithese eshte i vleresuar si fizibel, opsioni me 5% probabilitet te perseritjes se plotes u eliminua nga lista e opsioneve.
- Faktoret ekonomik te opsionit jane me te favorshmit.
- Kostot e investimit jane me te ultat, duke rritur potencialin per terheqjen e fondeve dhe duke ulur riskun e diponueshmerise se kostove te shfrytezimit dhe mirembajtjes.
- Besohet se kontrolli i forte mbi shfrytezimin e inerteve nuk mund te arrihet per momentin dhe administrat qendrore dhe lokale e ka te veshtire te vendos zbatimin e rregullave.
- Per te perfituar nje forcim te mbrojtjes nga permbytjet, niveli i projektuar per plota me probabilitet perseritjeje 3% mund te siguroje qe niveli i kreut te argjianturave per prurjen kontrolluese me probabilitet perseritjeje 1% te lejoje edhe nje hapesire te lire.

Ne keto kushte megjithese opsioni A2 eshte vleresuar si me i favorshmi duke marre parasysh veshtiresite per pastrimin e shtratit dhe problematiken qe mund te sjelli zbatimi me rigorozitet i ketyre projekteve, projektuesit kane percaktuar edhe zonat poshte ures se Autostrades ne te cilat mund te behen nderhyrjet e nevojshme. Planimetria e shtrirjes se ketyre zonave jane te paraqitura grafikisht ne Vizatimin Nr. TA3-ALB-ENV-03-GL-00-1-A1-1, te cilat shoqerohen edhe me profilat terrthore te ketij segmenti. Nga perjektuesit propozohet qe keto punime te realizohen me

*projekte te vecanta, te studjuar dhe te miratuar paraprakishte per cdo segment i cili propozohet per tu pastruar dhe profiluar, apo lartësuar me ane te argjinaturave. Zbatimi i tyre duhet te mbikeqyret ne menyre te vazhdueshme nga organet ligjore lokale sa i perkete perputhshmerise se tyre me projektin e miratuar. Keto nderhyrje te kontrolluara dhe monitoruara do te permiresojne parametrat hidraulik, sa i perkete ujepercjellshmerise se lumit Mat ne drejtim te detit Adriatik.*

Miartimi i ketij projekti do te mundesoj hapjen e rruges se investimeve, per mbrojtjen e ketyre zonave nga permbytjet. Ky projekt se bashku me planin e menaxhimit te Basenit te lumit Mat i cili eshte miratuar me Vendim te KKKU Nr. 3 date 12.10.2012 "Per miratimin e planit te menaxhimit te Basenit te lumit Mat" do te sherbejne si projektet baze mbi te cilat do te manaxhohet perdorimi i rezervave ujore ne kete basen. Marrja e vendimeve duke u nisur dhe bazuar ne keto studime te rendesishme eshte nje hap i rendesishem ne menaxhimin e integruar te burimeve ujore dhe do te mund te perdoret si nje praktike e mire nga ana e baseneve te tjera. Miratimi i ketij projekti eshte shume i rendesishem edhe per te gjitha nderhyrjet inxhinierike qe planifikohet te behen nga Bordi i Kullimit Lezhe per mbrojtjen e tokave nga permbytjet dhe erozioni. Keto nderhyrje do te mund te behen tashme ne perputhje me ligjin Nr. 8093, date 21.03.1996 "Per rezervat Ujore", kreu XI Mbrojtja e brigjeve, neni 46 "Mbrojtja e perkohshme", neni 47 "Mbrojtja e brigjeve", neni 48 "Veprimtarite ndertimore ne brigje" ku theksohet se Objektet qe i sherbejne mbrojtjes se bregut, si dhe muret, shluset e vepra te tjera ne breg, si ura: shkalle, gardhe, linja kablli ose tubash, ndertesa mbi kolona, hendeqe ose rruge, mund te ndertohen, ndryshohen a prishen, vetem me autorizim te posacem te autoriteteve te ujit.

Me respekt,

Fatmir MEDIU  
Zv/Kryetar i KKKU  
dhe  


Ministër i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujërave



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI KOMBETAR I UJIT**  
Keshilli I Basenit Ujembledhes Mat

**V E N D I M**

Nr. 0, date 27.05 2013

**Per**

**Miratimin e Projektit “Studim i Fizibilitetit per permiresimin e Infrastruktures mbrojtese nga permbytjet ne Lumin Mat.”**

Ne mbeshtetje te neneve 8, 14,20 te ligjit nr.8093 dt. 21.03.1996 “Per Rezervat Ujore” dhe te vendimit nr. 3 date 12.10.2012 te Basenit Lumit Mat “Per miratimin e planit te menaxhimit te Basenit Mat “ bazuar ne Ligjin Nr.8093, date 21.03.1996 “Per Rezervat Ujore “ ,kreu XI ‘Mbrojtja e brigjeve ,’Neni 46 “Mbrojtja e perkohshme “, Neni 47 ‘Mbrojtja e brigjeve “, Neni 48 ‘Veprimtarite ndertimore ne brigje “ ku theksohet se Objektet qe i sherbejne mbrojtjes se bregut ,si dhe muret ,shluset e vepra te tjera ne breg ,si ura ,shkalle ,gardhe ,linja kablli ose tubash ,ndertesa mbi kolona ,hendeqe ose rruge mund te ndertohen ndryshohen a prishen ,vetem me autorizim te posaçem te autoriteteve te ujit”.Pasi u lexua Relacioni dhe pas diskutimeve **Keshilli Basenit Mat :**

**V e n d o s i :**

- 1.Miratimin ne parim** te Projektit “ Studim i fizibilitetit per permiresimin e Infrastruktures mbrojtese nga permbytjet ne Lumin Mat”
- 2.Ngarkohet per ndjekjen dhe zbatimin e ketij Vendimi Agjensia e Ujrave te Basenit Mat.
- 3.Ky vendim i percillet K.K.U per miratim.
- 4.Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

**PERGJEGJESI I A.U.B. MAT**  
**Preng LALAJ**

**KRYETARI I K.B.U. MAT**  
**Pal DAJCI**